
NEKROLOGJI

PROF. DR. DEMIR DYRMISHI
(1940-2020)



Më 31 mars 2020 u nda nga jeta në moshën 80-vjeçare, studiuesi dhe kolegu ynë i nderuar, prof. dr. Demir Dyrmishi. Prof. Dyrmishi punoi rreth 53 vjet në arsim dhe në shkencë. Pas mbarimit të Shkollës së Mesme Pedagogjike në Elbasan dhe të Universitetit të Tiranës në degën histori-gjeografi në vitin 1970, ai shërbeu në vendlindjen e tij – Gramsh si mësues, drejtor shkolle dhe drejtor i Kabinetit Pedagogjik. Nga viti 1972 e deri sa doli në pension, në shtator të

vitit 2008, Demiri punoi si studiues në Institutin e Historisë të Akademisë së Shkencave e në Qendrën e Studimeve Albanologjike.

Demir Dyrmishi përvijohet në kujtesën tonë si një njeri me veti të veçanta dhe të qëndrueshme morale, humane, qytetare e shkencore. Disa cilësi të karakterit të tij spikasnin mbi të tjerat, në veçanti ndershmëria, thjeshtësia, komunikimi i drejtpërdrejtë e pa ekuivoqe. Ai ishte dhe mbeti gjithnjë një koleg mirëkuptues dhe familjar i devotshëm. Shqetësimi për mirërritjen dhe shkollimin e dy djemve të tij dhe përkujdesi i vazhdueshëm për gruan e sëmurë e shoqëruan gjatë gjithë jetës.

Gjatë karrierës shkencore gati 36-vjeçare në Institutin e Historisë, Demiri fitoi të gjitha gradat dhe titujt e mundshëm, duke filluar nga ‘Kandidat i Shkencave’ e deri tek ‘Drejtues Kërkimesh’ (Profesor doktor). Fryt i punës sistematike dhe me pasion janë katër monografite të tij, pjesët e shkruara e të botuara në veprën *Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi IV*, të botuar në vitin 2008, disa zëra në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, artikujt e shumtë studimorë të botuara kryesisht në revistën ‘Studime Historike’, hartimi me bashkautorësi i bibliografisë në tre vëllime për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, me dhjetëra kumtesa,

intervista e artikuj divulgativë të botuara në shtypin e përditshëm etj.

Demiri jetoi dy periudha kohore, të ndryshme nga njëra-tjetra, regjimin komunist dhe demokracinë, por ruajti të paprekura vetitë e tij më të mira humane e shkencore. Fusha e studimeve bashkëkohore në mënyrë të veçantë iu nënshtrua diskutimeve, rikonceptimeve dhe përpjekjeve për rishkrimin e saj. Prof. Dyrmishi, si edhe kolegët e tjerë u përfshinë në këtë proces, por pa humbur sensin e maturisë, seriozitetin dhe ndershmërinë profesionale. Me përpjekje dhe vullnet ai shfrytëzoi mundësitë dhe lehtësirat e krijuara pas rënies së regjimit komunist, duke kryer hulumtime të shumta në arkivat e hapura shqiptare dhe botimet e ndryshme, rezultat i të cilave ishin disa studime të rëndësishme për periudhën e Luftës së Dytë Botërore dhe atë të Luftës së Ftohtë. Monografitë dhe artikujt e tij shkencorë kanë trajtuar dhe ndriçuar probleme delikate dhe shumë të ndjeshme për opinionin publik e shkencor të historisë bashkëkohore.

Prof. Demiri iu rikthye studimit të përfunduar në vitin 1984, kushtuar “bandave dhe organizatat kriminale”, të cilin e rikonceptoi e rishkroi, siç përmend vetë ai, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, duke na paraqitur një studim të ri, larg ndikimeve të politikës për kundërshtarët e regjimit që u vendos në Shqipëri pas luftës, në periudhën 1944-1948. Organizatat politike ilegale të krijuara pas çlirimit të vendit u trajtuan si organizata opozitare, antikomuniste. Monografia e re sillte një kontribut të rëndësishëm për njohjen e periudhës së vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Ndryshimeve iu nënshtrua edhe monografia e hartuar prej tij, para viteve 90-të, mbi ‘Klasën punëtore në Shqipëri’. Në vend të saj, prof. Dyrmishi shkroi monografinë e re me titull “Punëtorët në Shqipëri (1944-1960)”. Ndryshe nga monografia e mëparshme, monografia e re nuk i shihte më punëtorët si ‘klasë politike e ideologjike që kontrollonte e drejtonte shoqërinë shqiptare’, por thjesht si forcë pune në prodhimin shoqëror.

Pjekuria shkencore e prof. Dyrmishit u materializua në mënyrë të veçantë me shkrimin dhe botimin e librit “Lufta politike në udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqiptare (PPSH) 1944-1960” e cila u botua në vitin 2011, tre vjet pas daljes në pension. Libri i fundit studimor i prof. Dyrmishit u konsiderua nga recensentët si monografia e parë e plotë, që trajtonte këtë problem për herë të parë dhe që mbështetej gjerësisht në dokumentet e reja arkivore. Megjithëse në moshë jo aq optimale, autori kreu hulumtime të gjera në fondet arkivore shqiptare, duke gjurmuar hap

pas hapi ngjarje, figura e procese historike. Konkluzionet e tij për natyrën e luftës brenda gjirit të PKSH (PPSH) dhe për motivet e saj u mirëpritën në shtypin shkencor shqiptar. Pjesë e punës së prof. Dyrmishit ishte edhe mësimdhënia në Universitetin e Tiranës dhe kontaktet e shumta me njerëzit e vendlindjes së tij, Gramshit, të cilat nuk u ndërprejnë gjatë gjithë jetës. Pas daljes në pension, Demiri vazhdoi të ruajë lidhjet me Institutin e Historisë dhe me kolegët e tij, ndërkohë që zyra e tij e punës u zhvendos në Bibliotekën Kombëtare ku ai kalonte shumicën e kohës.

Me largimin e Demirit ne humbëm një shok të mirë, që mbarte paqe e mirësi, historiografia një zë të veçantë e origjinal, ndërsa familjarët u ndanë nga krijuesi, mbrojtësi dhe kultivuesi i saj i dashur.

Prof. dr. Hamit KABA

